



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 84, datë 16.02.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATIT TË DIPLOMUAR
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 16.02.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2021-2022, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me nenin 34, pika 1/1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 532/1 prot., datë 01.07.2022, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr. 3775 prot., datë 01.07.2022.
- 1.1 Arsyeja e kohëzgjatjes së procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin e diplomuar z. {...}, lidhet me faktin e nisjes dhe përfundimit të procedimit disiplinor nga Shkolla e Magjistraturës. Në vijim të verifikimit të kësaj procedure, nga ana e Këshillit janë ndërmarrë disa hapa proceduralë, siç do të parashtrihen përgjatë këtij vendimi. Si rrjedhojë, krahas procedurës së verifikimit që është realizuar nga Këshilli për kandidatët e diplomuar në vitin 2021-2022, për situatën e krijuar për shkak të procedimit disiplinor për z. {...}, verifikimi i tij ishte më i gjatë në kohë. Për këtë kandidat të diplomuar ka qenë i nevojshëm verifikim shtesë dhe i veçantë i ndërmarrë nga Këshilli në funksion të

masës disiplinore të marrë nga Shkolla e Magjistraturës, referuar sjelljes dhe etikës së tij, siç do të trajtohet më poshtë.

2. Po ashtu, z. {...} nuk ka kërkuar të emërohet magjistrat në vitin pasardhës, sikurse lejohet nga neni 32, pika 2, i Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës”*.
3. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, në përputhje me nenin 34, pika 1, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”*, i ndryshuar (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 21, datë 17.01.2022, vendosi *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2021-2022*, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për kandidatin z. {...}, si relator u caktua z. Klodian Kurushi.
4. Më datë 17.01.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.
5. Brenda afatit treditör, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. Më datë 24.01.2022, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.
7. Brenda afatit pesëditor, kandidati z. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin *“Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”* pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

8. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 01.02.2022, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.
9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR

A. Për kushtet e emërimit

10. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: *“1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”*.
11. Nga kjo dispozitë kushtetuese identifikohen dy kushte emërimi si magjistrat: *“shtetësia shqiptare”* dhe *“përfundimi i formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës”*.

A.1 Për kushtin e shtetësisë shqiptare

12. “Shtetësia shqiptare” është përcaktuar si kriter kandidimi për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 28, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Për këtë shkak, ajo është verifikuar në rastin e kualifikimit të z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019 - 2020, sipas Vendimit nr.183, datë 02.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
13. Pavarësisht kësaj, sa kohë kjo rrethanë është e ndryshueshme, në funksion të verifikimit të kushtit të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar, të z. {...}, kjo rrethanë u verifikua sërish. Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 01.04.2022, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

A.1 Për kushtin e përfundimit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës

14. Siç u parashtrua, neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe neni 35, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit të Statusit¹, për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, kërkojnë përfundimin e formimit fillestar/diplomimin në Shkollën e Magjistraturës.
15. Bazuar në vendimin nr. 25, datë 29.06.2022, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë me Shkresën 563 prot., datë 12.07.2022 të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se z. {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2019 - Qershor 2022 dhe në përfundim të vitit akademik 2021-2022 është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

B. Për kriteret e emërimit

16. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se gjyqtarët emërohen pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit, ndërkohë që kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj. Në bazë të këtij autorizimi kushtetues, Ligji për Statusin, në nenin 35, ka përcaktuar kriteret e emërimit të kandidatit magjistrat të diplomuar.

B.1 Për kriterin e vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës

17. Neni 35, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkojnë që kandidati të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.
18. Bazuar në Vendimin nr. 25, datë 29.06.2022, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjellë me Shkresën 563 prot., datë 12.07.2022, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati z. {...} është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2021-2022:
 - a) me 94 % të pikëve, pra *“është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”*;
 - b) është vlerësuar me 594 pikë, domethënë *“shumë mirë”*, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *“është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”*.

¹ “1. I diplomuari emërohet magjistrat ...”.

19. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson këto kriteret të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar.

B.2 Për kriterin e pasurisë

20. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të ketë kaluar sërish verifikimin e pasurisë, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.
21. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë ..., nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ..., organet e administratës tatimore dhe doganore, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”.*
22. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të pasurisë, në përfundim të të cilit është konkluduar se ai plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr.183, datë 02.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
23. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} u kërkua raportim nga organet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.
24. Konkretisht, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Raportin nr. 717/24 prot., datë 24.03.2022.
25. Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidati z. {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.
26. Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja, për periudhën mbas kontrollit të plotë pasuror të kryer për të si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se për kandidatin:
 - a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) nuk ka kryer deklaram të rremë;

- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
27. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} iu kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- 27.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. 1575/2 prot., datë 24.02.2022, ku për kandidatin {...}, nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.
- 27.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 1928/1 prot., datë 18.02.2022, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.
28. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga organet si më lart u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.
29. Gjatë verifikimit nuk rezultoi nevoja për kërkimin e ndonjë të dhëne tjetër të vlefshme për qëllimet e verifikimit, pranë ndonjë organi publik, personi fizik ose juridik tjetër.
30. Nga verifikimi sërish i kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:
- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B.3 Për kriterin e figurës

31. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.
32. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e ... figurës ..., prokuroria, gjykata, ..., Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të ... figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për*

organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ...”.

33. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të figurës, në përfundim të të cilit është konkluduar se ai plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr.183, datë 02.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
34. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.
35. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit z. {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.
36. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 60/1 prot., datë 22.02.2022, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidatin z. {...}.
37. Për kandidatin z. {...}, në kushtet kur ai, në momentin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ka përmbushur detyrimet sipas Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe i është nënshtruar kontrollit sipas këtij ligji, referuar për këtë Vendimit nr.183, datë 02.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të verifikimit sërish të figurës për të, u kërkua informacion i përditësuar nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo e fundit, me shkresën nr. 660/5 prot., datë 03.03.2022, për kandidatin z. {...} informoi se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 18.06.2019; - formulari është regjistruar me numrin unik 000420; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formular nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga shërbimi i gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, nuk ka rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo të gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruar; - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.
38. Për verifikimin sërish të figurës së kandidatit z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, me shkresën nr. 140/26 prot., datë 17.03.2022, ka dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “...z. {...} nuk është marrë në cilësinë e personit në hetim në një ndonjë procedim penal, ndaj tij nuk janë zbatuar masa sigurimi me karakter personal ose pasuror, nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, pushuara apo pezulluara, për periudhën Tetor 2019 e në vijim...”
39. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila e ka

- dërguar atë me shkresën nr. 862/1 prot., datë 21.02.2022, nga përmbajtja e të cilës nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal.
40. Së fundi, për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me disiplinën e kandidatit gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar për magjistrat në kushtet kur, sipas nenit 255 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar², kandidati për magjistrat është subjekt i përgjegjësisë disiplinore, ndërsa janë organet e Shkollës së Magjistraturës sipas këtij ligji³ ato që kanë përgjegjësinë e verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe procedimit disiplinor të kandidatëve për magjistrat.
- 40.1 Me shkresën nr.101/1 prot., datë 03.02.2022, si përgjigje e parë drejtuar Këshillit, ndër të tjera, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se për kandidatin z. {...}, organi disiplinor nuk ka regjistruar procedim disiplinor dhe kundrejt tij nuk është marrë masë disiplinore.
- 40.2 Me shkresën nr. 533/3, datë 04.07.2022 të Shkollës së Magjistraturës, si përgjigje e radhës, Këshilli vihet në dijeni se me vendimin nr.533/2 prot., datë 04.07.2022 ka filluar hetimin disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat z. {...}, si person i dyshuar për shkelje të karakterit disiplinor, sipas parashikimit të germës “e” të Nenit 33 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
- 40.3 Ky hetim disiplinor ka ardhur si pasojë e ankesës të bërë nga ana e znj. Afërdita Maho e cila ushtron detyrën e gjyqtares pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë. Ankesa është protokolluar më datë 01.07.2022. Kjo gjyqtare është caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të kryejë detyrën e mentores së praktikës profesionale të kandidatit për magjistrat z. {...}.
- 40.4 Znj. Maho pretendoi se në mënyrë të përsëritur në datat 29.06.2022 dhe 30.06.2022, z. {...} ka hyrë në zyrën e saj të punës dhe ka ushtruar presion për të ndryshuar vlerësimin për praktikën profesionale nga 97 në 100 pikë. Sipas ankueses/kallëzueses, kandidati për magjistrat ka shfaqur komunikim me sjellje të papërshtatshme dhe jo etike, në prani të sekretares gjyqësore, si edhe duke përfshirë në pretendimet e tij edhe zv. Kryetaren e gjykatës. Konkretisht sipas ankueses – toni i përdorur dhe sjellja e papërshtatshme në prani të sekretares në datë 29 qershor, e cila në datën 30 qershor u shoqërua edhe me kërkesën e informacionit për kandidatin tjetër magjistrat N.D që ishte në mentorim, janë të papërshtatshme. Shprehjet e përdoruara në korridoret e gjykatës “*Haram e paç ndihmën time që kam rregulluar vendimet e tua paçavure*” dhe qëndrimi i kandidatit duke

² “...kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljet disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e brendshme të shkollës”.

³ Neni 256, sipas të cilit: “1. Prokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja “gj”, kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të kandidatëve për magjistratë. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga Zëvendësprokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja “gj”, të këtij ligji. ...”, si dhe neni 257, sipas të cilit: “1. Komisioni Disiplinor që kryen procedimin disiplinor dhe cakton masën disiplinore është i pavarur dhe i nënshtruar vetëm ligjit. 2. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja “d”, të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy kandidatë për magjistratë të zgjedhur me votë të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magjistratë. ...”.

- e vënë në dijeni mentoren se po kryente regjistrimin e bisedës në zyrën e gjyqtarit sipas ankueses janë të papërshtatshme dhe jo etike.
- 40.5 Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u vu në dijeni të këtij procedimi disiplinor, me vendimin nr. 273, datë 20.07.2022, ka vendosur ndër të tjera: *“1. Pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për t’u emëruar magjistrat z. {...}, të filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 21, datë 17.01.2022, deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të procedurës së hetimit disiplinor të filluar nga Prokurori për Disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës. 2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...} dhe Shkollës së Magjistraturës. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për magjistrat,....”*
- 40.6 Në vijim, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. 533/8 prot., datë 22.07.2022 *“Vënie në dijeni”*, bën me dije vendimin nr. 533/7, datë 21.07.2022 të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës *“Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore”*, me të cilin është mbyllur procedimi disiplinor në ngarkim të kandidatit për magjistrat z. {...} si edhe gjithë aktet që shoqërojnë rastin përkatës. Pjesë e akteve shoqëruese të këtij procedimi disiplinor janë edhe: i) procesverbali për intervistimin e znj. Afërdita Maho; ii) procesverbali për dokumentimin e thënieve të z. {...}; iii) procesverbali për marrjen e dokumenteve: Referencë nga gjyqtare Anila Karanxha; letër rekomandimi nga gjyqtar Artan Gjërmeni; letër referencë nga prokuror Dritan Nushi; Letër referencë nga gjyqtar Emiljano Ruli; Referencë nga gjyqtar Besnik Hoxha; si edhe iv) formulari i vlerësimit të praktikës profesionale nga plotësuar nga mentore Afërdita Maho.
- 40.7 Vendimi i mësipërm nr. 533/7, datë 21.07.2022 ndër të tjera ka disponuar: *“Të pranohet marrëveshjen e përbashkët për pranimin e shkeljes dhe të masës disiplinore të nënshkruar në datën 20.07.2022, mes kandidatit për magjistrat, në vitin III të stazhit profesional z. {...} dhe z. Henrik Ligori, me detyrë ad hoc Prokuror për disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës, si të drejtë dhe të mbështetur në ligj; të njoh me këtë vendim palët në marrëveshje dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor; Ky vendim i jep formë të prerë marrëveshjes së arritur dhe mbyll procedimin disiplinor në ngarkim të kandidatit për magjistrat z. {...}.”*
- 40.8 Në përmbajtje të aktmarrëveshjes rezulton se: *“Kandidati për gjyqtar z. {...}, pranon se ka gabuar është treguar emocional dhe i pamatur në komunikim dhe mentoren dhe për këtë ka kërkuar ndjesë të sinqertë. Ai pranon që sjellja e tij të cilësohet si **“Cenim i etikës profesionale gjatë komunikimit me mentoren, në periudhën e stazhit profesional”**, e parashikuar nga Neni 33, par.1, shkronja “e” e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.”*
- 40.9 Në vendimin nr. 533/7, datë 21.07.2022 ndër të tjera është argumentuar se: *“Në zgjedhjen e masës disiplinore “vërejtje” janë mbajtur parasysh kriteret që normon neni 115, par.1 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin...” lidhur me rrethanat e shkeljes. Janë mbajtur parasysh shkalla e fajësisë dhe pasojat e shkeljes, e cila normalisht ka cenuar raportin mentor-*

kandidat. Por, janë mbajtur parasysh gjithashtu, fakti i ngarkesës së lartë të punës që ka përballur kandidati gjatë stazhit, fakti se ai ka reflektuar më pas dhe ka kërkuar ndjesë, ka punuar për të zbehur pasojat e shkëljes, duke i normalizuar marrëdhëniet me mentoren e tij, si dhe faktin se gjatë procedimit disiplinor është treguar i përgjegjshëm dhe bashkëpunues...për sa më sipër vlerësoj se masa e zgjedhur është e drejtë dhe proporcionale.”

- 40.10 Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 376, datë 19.09.2022 ka vendosur: *"1. Shfuqizimin e vendimit nr.273, datë 20.07.2022 të KLGJ-së "Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për t'u emëruar magjistrat z. {...}". 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kandidatit për magjistrat z. {...}. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet z. {...}. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për magjistrat, z. {...}.*
41. Me shfuqizimin e vendimit të pezullimit, Këshilli ka kryer veprimet verifikuese lidhur me figurën, të pavarura nga ato të kryera nga organi procedues- Shkolla e Magjistraturës. Janë marrë si prova dokumentet e administruara nga Shkolla e Magjistraturës, ku në përfundim të procedimit disiplinor është marrë masa "vërejtje". Janë marrë shpjegimet e kandidatit të diplomuar. Kjo është arsyeja e shpjeguar edhe në hyrje të këtij vendimi, lidhur me zgjatjen e procesit të verifikimit të kandidatit të diplomuar z. {...}, krahasuar me kandidatët e tjerë të diplomuar në përfundim të vitit akademik 2021-2022.
42. Kandidati për magjistrat gjatë hetimit administrativ, në rrugë elektronike më datë 21.09.2022 ka dhënë shpjegime mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit të shkëljes dhe masës disiplinore të datës 20.07.2022.
43. Ndër të tjera kandidati është shprehur se: *"Më duhet të shpreh para jush qysh në krye të herë, ashtu sikundër kam parashtruar para organit disiplinor, se jam i keqardhur për situatën e krijuar me mentoren udhëheqëse të praktikës profesionale znj.Afërdita Maho. Me gjyqtaren gjatë 4 muajve të praktikës kemi patur një bashkëpunim shumë të mirë. Unë jam angazhuar maksimalisht gjatë praktikës, duke marrë pjesë në seancat gjyqësore, në studimin e dosjeve, në dhënien e opinioneve ligjore dhe në arsyetimin e vendimeve (gjatë 4 muajve praktikë profesionale kam arsyetuar mbi 50 vendime gjyqësore). Feedback-u i ditëpërditshëm nga ana e gjyqtarës për punën time ka qenë shumë pozitiv. Jam përgëzuar dhe vlerësuar nga gjyqtarja për cilësinë e arsyetimeve dhe në tërësi për angazhimin tim në zyrë. Gjithashtu, kam ruajtur raporte shumë të mira edhe në nivelin personal, duke ruajtur etikën e komunikimit kandidat-mentor, por edhe me stafin e gjykatës.*
44. Nisur nga këto rrethana kam pritur që në përfundim të praktikës të vlerësohem me pikët maksimale, në proporcion të drejtë me punën time. Një gjë e tillë për fat të keq nuk ndodhi. Për këto arsye, i kam kërkuar mentores që të rishikonte vlerësimin tim, nisur edhe nga fakti që si pasojë e vlerësimit jo maksimal, kam rezultuar me ulje në renditjen e kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës: nga vendi i 3-të, në të 4-tin. Një gjë e tillë nuk është pranuar nga mentorja dhe unë kam këmbëngulur, që brenda një arsyeje të shëndoshë vlerësimi për mua të rishikohej.

45. Në ditët kur kam komunikuar me mentoren kam qenë i ngarkuar emocionalisht, për shkak që parashtrova, por edhe si pasojë e lodhjes nga ngarkesa e punës gjatë praktikës. Në këto kushte kam gabuar që debatova me mentoren: ajo e perceptoi si presion këmbënguljen time për ndryshimin e vlerësimit dhe debatin që patëm. Në fakt, unë nuk kam dashur të bëj presion, por e kuptoj se në momentin që mentorja nuk pranoi të bënte rishikim, ishte e udhës që ky diskutim të mbyllej. Ju lutem të mbani parasysh gjendjen time emocionale, të shkaktuar nga një lloj zhgënjimi në raport me pritshmëritë e mia, për shkak të vlerësimit të vazhdueshëm me terma maksimale prej mentores për punën e kryer dhe për faktin se me gjyqtaren gjatë praktikës profesionale kam pasur marrëdhënie të shkëlqyera.
46. **Jam jashtëzakonisht i keqardhur për situatën e krijuar në komunikim me mentoren, gjë që do të duhet të ishte menaxhuar ndryshe nga unë dhe të ishte shmangur. Në një moment të dytë kam komunikuar me znj. Maho, dhe i kam shprehur keqardhjen dhe ndjesën time lidhur me çfarë ndodhi. Unë kam reflektuar për veprimet e pamatura në komunikimin me të, gjë të cilën ia kam shprehur asaj edhe në prani të zv.kryetares së gjykatës.**
47. Dua të shtoj se nuk është në natyrën time krijimi i tensioneve të kësaj natyre. Gjatë praktikës paraprofesionale dhe profesionale, jam mentoruar nga disa magjistratë, me të cilët kam patur marrëdhënie të shkëlqyera; vlerësimet e tyre për mua si kandidat janë shumë të mira. Për këtë qëllim kam paraqitur para organit disiplinor si provë dokumentare referencat e tyre. Nisur nga përmbajtja e tyre, rasti për të cilin ka filluar kjo procedurë, është një rast i veçuar, i cili nuk duhet të përgjithësohet për të nxjerrë përfundime lidhur me cilësitë e mia të komunikimit në raport me mentorët, kolegët apo palët me të cilat do të kem të bëj në veprimtarinë time profesionale. E theksoj se jam i keqardhur për sa ndodhi dhe kam kërkuar ndjesë të sinqertë.
48. Duke marrë parasysh sa sipër, është lidhur marrëveshja e përbashkët e pranimit e datës 20.07.2022, duke pranuar shkeljen e lehtë disiplinore “cenimin e etikës në komunikim” dhe masën përkatëse disiplinore “vërejtje”. Nisur nga kushtet dhe kriteret e nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, shkelja e lehtë disiplinore dhe masa përkatëse “vërejtje”, të caktuara në marrëveshjen e përbashkët të pranimit, mendoj se nuk përbën shkak pengues për kalimin e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Ju lutem të merren parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ka ndodhur debati që çoi në caktimin e masës disiplinore, posaçërisht fakti që kjo është një ngjarje e izoluar dhe që nuk është karakterizuese për personin tim, si dhe fakti i reflektimit serioz dhe të sinqertë me pas...”
49. Nga rrethanat si më lart, në përfundim të procedimit disiplinor, kualifikimi i sjelljes së kandidatit është cilësuar si “shkelja e rregullave të etikës profesionale dhe atyre që lidhen me veprimtarinë e gjyqtarit, prokurorit a nëpunësit në organet e sistemit të drejtësisë, ku kandidatët marrin pjesë në veprimtari, kryejnë stazhin paraprofesional dhe profesional”, bazuar në Nenin 33 të rregullores së Shkollës së Magjistraturës, në të cilën parashikohen shkeljet disiplinore të kandidatëve në Formimin Fillestar pavarësisht nga profili që kanë.
50. Mbi sa më sipër, arrihet në përfundimin se: të gjithë elementët e sjelljes së z. {...}, lidhur me: i) rishikimin e vlerësimit të dhënë nga mentorja; ii) toni i përdorur dhe sjellja e

papërshtatshme në prani të sekretares në datë 29 qershor; iii) kërkesa e informacionit për vlerësimin e kandidatit tjetër magjistrat N.D që ishte në mentorim; iv) shprehjet e papërshtatshme të përdorura në korridoret e gjykatës “*Haram e paç ndihmën time që kam rregulluar vendimet e tua paçavure*”; dhe v) vënia në dijeni të mentores se po kryente regjistrimin e bisedës në zyrën e gjyqtarit në datë 30 qershor; të pretenduara nga ankuesja/kallëzuesja znj. Maho janë bërë pjesë e procedimit disiplinor të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës sipas Nenit 256 të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”. Kjo rezulton nga vendimi nr. 533/7 prot., datë 21.07.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore”, si edhe aktet që shoqërojnë procedimin disiplinor.

51. Masa e vendosur “vërejtje” është marrë në përputhje me nenin 261 të ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, ku parashikohen *Masat disiplinore ndaj kandidatëve për magjistratë*, si edhe në zbatim të nenit 115 të ligjit 96/2016 ku parashikohen *Kriteret për caktimin e masës disiplinore*.
52. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:
 - a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
 - b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
 - c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
 - ç) për kandidatin nuk ka të dhëna në lidhje me sjelljen etike dhe morale të tij, mbi të cilat të ngrihen dyshime për cenim të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, përveç atyre të konstatuara në pikat 40-51 të këtij vendimi. Këto të dhëna do të trajtohen në kuadër të kriterit të zgjedhshmërisë, referuar kriterit të figurës/etikës së kandidatit të diplomuar;

B.3 Për kriteret e zgjedhshmërisë

53. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.
54. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 4/1. *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: a) burimet*

*financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ç) **ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit;**”.*

55. Në kuptim të shkaqeve të tjera përjashtuese në lidhje me pasurinë dhe figurën sipas shkronjës “ç”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sa i përket emërimit si magjistrat, vlen të konsiderohen shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat, të cilat janë të parashikuara dhe të përsëritura edhe në Nenin 66 të Ligjit për Statusin që ka të bëjë me shkaqet e pazgjedhshmërisë.
56. Shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat përcaktohen në nenin 66, pika 1, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“1. Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon: a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji; ...”*. Pra, në kuptim të kësaj dispozite, kriteret sipas nenit 28 të ligjit janë në fakt dhe kritere zgjedhshmërie si magjistrat. Po ashtu, kjo dispozitë lejon Këshillin e Lartë Gjyqësor të verifikojë pa u kufizuar në kohë të shkaqeve të pazgjedhshmërisë si magjistrat, madje edhe atëherë kur statusi i magjistratit është fituar.
57. Neni 28 i Ligjit për Statusin përcakton *“Kriteret e pranimit në formimin fillestar”*. Verifikimi i këtyre kriterëve për kandidatin z. {...}, në përputhje me nenin 30 të Ligjit të Statusit, është bërë në momentin e kandidimit të tij për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa ai është lejuar të marrë pjesë në provim, ndërkohë që, në përfundim të provimit të pranimit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 15.05.2019, ka miratuar listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Provimit me shkrim dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, të provimit të pranimit për vitin akademik 2019-2020. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.
58. Gjithsesi, për kandidatin z. {...} është bërë verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës. Ky verifikim është përfunduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar Vendimit të tij nr.183, datë 02.10.2019.
59. Në rastin e verifikimit sërish të disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë diferencën kohore mes momentit të aplikimit për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës (Shkurt 2019), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve (prill 2019), si dhe momentit kur Këshilli është shprehur për verifikimin e kushteve dhe

- kritereve ligjore të kandidimit të tij për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2019). Dhe po ashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë dhe faktin se shumica e kritereve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990). Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë detyrimin e tij konstant për verifikimin e kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
60. Në kuptim të nenit 28 të ligjit “Për Statusin...”, kritere zgjedhshmërie si magjistrat identifikohen: a) *zotësia për të vepruar*; b) *shtetësia shqiptare*; c) *arsimimi*; ç) *përvoja profesionale*; d) *gjendja gjyqësore*; dh) **disiplina në punë**; e) *anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit*; ë) *qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*; f) *qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*.
61. Gjatë verifikimit sërish të kandidatit në Këshillin e Lartë Gjyqësor janë vlerësuar të gjithë njoftimet e mbërritura në kuadër të kritereve të nenit 28 të ligjit “Për Statusin...”. Sipas njoftimeve të mbërritura, nuk ka rezultuar për kandidatin ndonjë e dhënë e ndryshme nga ato të verifikuara më parë sa i përket kritereve sipas kësaj dispozite (Kriteret e pranimit në formimin fillestar), përveç atyre të trajtuara në pikat 40-50 të këtij vendimi.
- 61.1 Kjo situatë që i referohet masës disiplinore në fuqi, të dhënë nga Shkolla e Magjistraturës, rregullohet nga ligji “Për Statusin...”, i ndryshuar dhe ligji “Për Organet e Qeverisjes...”, i ndryshuar.
- 61.2 Ligji “Për Statusin...” për verifikimin e figurës së kandidatit të diplomuar referon në nenet: i) neni 28 –*Kriteret e pranimit në formimin fillestar*; ii) neni 32 –*Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatit për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës*; iii) neni 35 –*Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatit të diplomuar*; iv) neni 66 *pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria e magjistratit*;
- 61.3 Ligji “Për Qeverisjen...” në rastin e procedimit disiplinor të kandidatit të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës parashikon rregullat e posaçme të hetimit disiplinor referuar: i) neneve 255-259 - *përgjegjësia disiplinore dhe hetimi i procedimit disiplinor*; ii) neni 261 - *masat disiplinore ndaj kandidatëve për magjistratë*.
- 61.4 Verifikimi i z. {...}, në ndryshim nga kandidatët e tjerë të diplomuar, përfshin edhe rastin e verifikimit të figurës së tij, në kushtet kur ka një masë disiplinore në fuqi të dhënë nga Shkolla e Magjistraturës.
62. Për sa më sipër Këshilli vlerëson se në rastin e kandidatit {...}, disiplina, e cila rezultoi e cenuar për shkak të shkeljes së konstatuar në vendimmarrjen e Shkollës së Magjistraturës, është një rast që merret në konsideratë nga Këshilli në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit për magjistrat.
63. Në rastin objekt shqyrtimi, Këshilli çmon se natyra e shkeljes së kryer nga kandidati i diplomuar, për të cilën ai ka marrë masën disiplinore “vërejtje”, nuk është e tillë dhe aq e rëndë sa të përbëjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e tij për ta emëruar si magjistrat, siç do të analizohet në vijim.

64. Referuar germës “c” të pikës 4/1 të nenit 32 në ligjin “Për Statusin...”, Këshilli vlerëson se shkelja e konstatuar gjatë procesit të verifikimit të figurës, si dhe duke marrë në konsideratë konkluzionet e arritura në përfundim të procedimit disiplinor nga Shkolla e Magjistraturës, nuk përcaktohet si një shkelje që të përfshihet në grupin e sjelljeve të rënda, të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor.
65. Veprimet e konstatuara si: kërkesa për rishikimin e vlerësimit, shprehjet e papërshtatshme të përdorura nga ana e kandidatit në korridoret e gjykatës “*Haram e paç ndihmën time që kam rregulluar vendimet e tua paçavure*” dhe qëndrimi i kandidatit duke e vënë në dijeni mentoren se po kryente regjistrimin e bisedës në zyrën e gjyqtarit konkludojnë në cenim të etikës. Por duke marrë në analizë rrethanat e kryerjes së kësaj sjellje si: një ngjarje e shkëputur nga veprimtaria e kandidatit (sjelljet me mentorët e tjerë tejet korrekte); situata është momentale në datat 29-30 qershor (kur u njoh me vlerësimin e mentores); sjellje e shkujdesur dhe e pamenduar e tij e kryer në përfundim të vitit akademik të lodhshëm; si edhe faktin që pasojat e sjelljes janë rikuperuar, duke i kërkuar falje mentores A.M., të çojnë në përfundimin se shkelja ekziston, por jo thellësisht serioze, e cila sipas germës “c” të pikës 4/1 të nenit 32 në ligjin “Për Statusin...” nuk është propocionale që të përbëjë shkak për skualifikimin e kandidatit të diplomuar.
66. Për kandidatin e diplomuar z. {...} rezulton një masë disiplinore (vërejtje) në fuqi. Në nenin 28 të ligjit “Për Statusin...” janë parashikuar kritere kumulative për pranimin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, ndër to në germën “dh” parashikohet edhe mospasja e një mase disiplinore në fuqi. Situata e z. {...} nuk përkon me rastin e parashikuar në germën “dh” të nenit 28 të Ligjit për Statusin për shkak se: i) kandidati e ka kaluar me sukses fazën e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës; ii) ka fituar statusin kandidat magjistrat, i cili gjatë kësaj periudhe i nënshtrohet procesit të Formimit Fillestar dhe diplomohet. Gjithsesi, kandidati për magjistrat i nënshtrohet verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe procedimit disiplinor të iniciuar nga Shkolla e Magjistraturës në përputhje me ligjin “Për Organet e Qeverisjes...” Shkolla e Magjistraturës si një prej institucioneve përbërëse të sistemit të drejtësisë, ndër të tjera ushtron funksionin e saj edhe në drejtim të kontrollit të etikës dhe sjelljes së kandidatëve magjistratë gjatë procesit të formimit fillestar të tyre.
67. Shkolla e Magjistraturës bazuar në parashikimet e nenit 256 të ligjit “Për Qeverisjen..., kur konstaton rast të nisjes së hetimit disiplinor për kandidatin magjistrat, fillon hetimin “ex-officio”. Hetimi dhe procedimi disiplinor për kandidatët për magjistratë në këtë situatë, u nënshtrohet rregullave të hetimit dhe procedimit disiplinor që Ligji për Statusin⁴ parashikon për magjistratët (gjyqtarë dhe prokurorë).
68. Në këtë kuptim, masa disiplinore që mund t’i jepet një gjyqtari nga Këshilli, e ndryshme nga masa “shkarkim nga detyra” e lejon atë që të ushtrojë funksionin si magjistrat. Pra,

⁴ Neni 258 i ligjit 115/2016 “*Organi kompetent për hetimin disiplinor dhe procedimin disiplinor zbaton, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, dispozitat e kreut V për përgjegjësinë disiplinore të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

jo çdo masë disiplinore e dhënë ndaj magjistratit, sjell si pasojë përfundimin e statusit, sipas nenit 66 të Ligjit për Statusin.

69. Në këto rrethana, Këshilli vlerëson se në rastin objekt shqyrtimi, mbajtur në vëmendje: i) statusin që ka z. {...} si kandidat për magjistrat i diplomuar; ii) natyrën që ka procedimi disiplinor dhe rregullave që i nënshtrohet, të cilat janë njëjta me magjistratët gjyqtarë; iii) subjektin që ka kryer hetimin disiplinor dhe ka marrë masën disiplinore - Shkolla e Magjistraturës, si një prej organeve të qeverisjes së sistemit gjyqësor, arrihet në përfundimin se masa disiplinore vërejtje nuk passjell automatikisht skualifikimin e kandidatit magjistrat të diplomuar.
70. Për sa më sipër, bazuar në: i) natyrën e shkeljes së konstatuar lidhur me sjelljen dhe etikën e kandidatit të diplomuar; ii) parimin e proporcionalitetit; dhe iii) vlerësimin tërësor të situatës të z. {...}, nuk arrihet në përfundimin për skualifikimin e tij. Masa disiplinore “vërejtje” është pjesë e dosjes personale të magjistratit të diplomuar, e cila vlen për vlerësimin në ecurinë e karrierës së tij si magjistrat.

III. KONKLUZIONE

71. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.
72. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021 - 2022 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR